

Forumi Qendror WEB.DEP eshte zhvilluar mbi bazat e projektit WEB.DEP “Pjesemarrja Demokratike e Ballkanit Perendimor” financuar nga Bashkimi European bazuar ne (6th Framework Programme)

Organizimi i Forumit Qendror

Forumi Qendror WEB.DEP mirëpret diskutime ne gjuhen angleze mbi tema qe perfshijne nje interes te perbashket per te gjithë vendet e Ballkanit Perendimor.

Faqja kryesore “**Forum Home**” liston te gjithë diskutimet mbi tema te ndryshme te klasifikuara ne baze te dates.

Faqja “**Temat**” liston te gjithë diskutimet mbi bazen e tematikes. Temat kryesore te diskutimeve mbulojne keto fusha:

- ❖ Art & Kulture
- ❖ Ekonomi & Biznes
- ❖ Edukim
- ❖ Mjedisi
- ❖ Te drejtat e Njeriut
- ❖ Puna
- ❖ Menyra e Jeteses
- ❖ Zhvillimi Rajonal
- ❖ Teknologji & Shkence
- ❖ Ceshtjet Sociale

Faqja “Rezultate” permbledh te gjithë diskutimet e mbyllura (te kaluara).

Se fundmi, dy minute “**Forumet WEB.DEP**” dhe “**Portalet WEB.DEP**” drejtojne pjesen tjetër te forumeve dhe lajmeve ne WEB.DEP.

Si formulohen diskutimet

Diskutimet ideohen nga nje **gazetar-kordinator** i Agjencive te Lajmeve te WEB.DEP ne bashkepunim me Administratorin e Forumit. Ai/ajo eshte pergjegjes per mbledhjen dhe rifreskimin e informacioneve te fundit shoqeruar nga diskutimet, monitorimin e diskutimeve, per mbylljen dhe permbledhjen e nje diskutimi dhe per marrjen e nje reagimi te rezultatit nga nje vendim i pershtatshem i politike beresve.. Cdo diskutim eshte ndertuar si vijon:

- ❖ Ka nje **Subjekt** qe mbulon tematiken kryesore e cila i perket njerës nga fushat e lartpermendura **Temat** (psh. Burimet Alternative te Energjise perfshihen ne Temen Mjedisi)
- ❖ Cdo Subjekt konsiston ne te pakten nje diskutim **Te hollesishem**, i cili mbulon ne detaje nje ceshtje me specifike ne brendesi te konceptit thelbesor te Subjektit (psh. burimet alternative te energjise ne Shqiperi). Ky pershkrim i detajuar i ceshtjes, i siguruar nga gazetari-kordinator, si dhe linket dhe dokumentet e duhura pasohen nga opinonet e shprehura ne nje blog..
- ❖ Nese te gjitha detajet mbi nje Subjekt jane mbyllur (psh.nuk pranohen me komente) subjekti zhvendoset automatikisht tek faqja e Perfundimeve.

Si mund te marresh pjese ne forum

Per te hyre ne kete forum ju duhet te ndiqni keto hapa:

Hapi 1 : Lundro

Ju mund te lundroni ne faqet e forumit dhe te lexoni diskutimet ne vijim ose ato te mbyllura.(Subjektet- Detajet) ne kategori te ndryshme (Temat) dhe Votimin elektronik. Informacionet e Pergjithshme si Kontakt, Forumi Qendror WEB-DEP eshte zhvilluar mbi bazat e projektit, WEB.DEP “Pjesemarrja Demokratike e Ballkanasve Perendimor” financuar nga EU bazuar ne (6th Framework Programme), Termat & Kushtet, Privatesia, Kushtet Ligjore mund te gjenden ne fund te faqes.

Gjithashtu mund te gjeni linke te forumeve te tjera te WEB.DEP.

Hapi 2: Regjistrohu

Ju duhet te regjistroheni per te marre pjese ne nje diskutim. Per tu regjistruar ju duhet te klikoni butonin ne te djathte. Pas shfaqjes se Termave& Kushteve, ju duhet te mbushni nje formular. Perdoruesi dhe Fjalekalimi, e-maili dhe CAPTCHA (numri ne fund) jane te detyrueshem per t’u plotesuar.

Ju lutemi te perdorni nje e-mail te sakte, sepse gjate regjistrimit verifikohet e-maili nese eshte aktiv. Vetem emri i perdoruesit shikohet nga pjesetaret e tjere te forumit. Pjesa tjeter e formularit eshte jo i detyrueshem per t’u plotesuar. Ne rast te gabimeve ose situatave jonormale, ndiqni mesazhet qe do shfaqen ne fund te faqes se regjistrimit. Ju lutem vini re qe Fjalekalimi dhe Perdoruesi duhet te jene te pakten 6 karaktere te gjate. Mbas nje regjistrimi te suksesshem, ju do merrni nje e-mail per verifikimin e hapjes se llogaris. Ju lutem ndiqni instruksionet e dhena dhe llogaria juaj do aktivizohet.

Hapi 3: Hyrja

Per te hyre ne forum, ju lutem fusni Fjalekalimin dhe emrin e Perdoruesit ne te djathte. Shenja “?” afer fjalekalimit perdoret per t’ju kujtuar fjalekalimin. Nese keni harruar fjalekalimin tuaj, duhet te shkruani perdoruesin dhe shtypni“?”. Fjalekalimi do ju dergohet me e-mail ne adresen tuaj.

Hapi 4: Posto nje koment

Per te postuar nje koment: kliko butonin “Posto” mbas komentit te fundit te publikuar. Ne fund do t’ju shfaqet nje kuti ku ju mund te shkruani mesazhin tuaj. Mbas te shkruani mesazhin kliko butonin “posto” poshte kutise. Mbani parasysh qe mesazhi juaj nuk do shfaqet direkt ne forum, sepse me pare duhet te aprovohet nga gazetari-kordinator duke ju permbajtur Termave& Kushteve. Kjo ju behet e ditur me ane te nje mesazhi.

Hapi 5: Ankohu

Nese ju per ndonje arsye(psh .racizem) shqetesoheni nga ndonje mesazh i publikuar ju mund te klikoni mbi “Ankohu”. Mbas klikimit ju duhet te plotesoni formularin e shfaqur duke specifikuar arsyet per te cilat ankoheni. Me pas formulari i dergohet gazetarit-kordinator i cili merr masat e nevojshme. Forma eshte e njejte si tek “Kontakt” shiko hapin 7) .

Hapi 6: Voto

Per te dhene nje vote ne Votimin Elektronik, beni zgjedhjen tuaj dhe klikoni “Voto tani”. Mbas kesaj ju do njiheni me rezultatet me te fundit te votimit. Nese ju keni votuar me pare per kete Teme, ju do njoftoheni me ane te nje mesazhi.

Hapi 7: Kontakto gazetar-kordinator

Duke klikuar mbi “Kontakto E-mail”, ne anen e djathte te pershkrimit te temes do ju shfaqet nje formular nga ku mund ti dergoni e-mail gazetarit-kordinator nga e-maili juaj, mund te shprehni gjithcka ju shqeteson ne lidhje me diskutimin ose per te propozuar nje teme te re per diskutim. E njejta procedure ndodh edhe kur klikoni “Ankohu” prane cdo postimi.

Hapi 8: Plotesoni pyetesoret

Ju mund te hyni ne pyetesoret online te WEB.DEF duke klikuar “Reagimi-pyetesoret” i cili gjendet ne te djathte. Duke plotesuar fushat/pergjigjet e kerkuara ju na beni te ditur reagimin tuaj, i cili na ndihmon te vleresojme dhe permiresojme keto forume.